



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 406 Akti

Nr. 437 Vendimi  
Tiranë, më 10.9.2021

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 4 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesuese
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore
<b>Olsi Komici</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 8.9.2021, ora 10:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Kaçe Agolli**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës.**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi rekomandimet e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit edhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Kaçe Agolli është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në pikën 4 të nenit 4 dhe në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4.

2. Me vendimin e trupit gjykues të datës 8.1.2020 është vendosur kryesuese komisionere Xhensila Pine, si dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.

3. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues që do të kryente procesin e rivlerësimit dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e tij.

4. Nga relatori janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Gjatë procesit të rivlerësimit është komunikuar me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet adresës elektronike.

5. Në datën 15.7.2020, trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, si dhe ta ftojë për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e tij.

6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore, ku paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit.

7. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli, në seancë dëgjimore në datën 8.9.2021, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 8.9.2021, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

9. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, së bashku edhe me një përfaqësuese ligjore, znj. I. R., e cila dha shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit dhe barrën e provës. Në përfundim, subjekti rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

10. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

11. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) informacionin e përditësuar lidhur me subjektin e rivlerësimit, nga institucionet ligjzbatuese;
- ç) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues;
- d) dokumentet shkresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- dh) deklaramet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- e) denoncimet nga publiku;

ë) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

12. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, konstaton se për subjektin Kaçe Agolli:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e saj;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

### 13. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, si vijon:

**1. Apartament dhe garazh**, përkatësisht, me sipërfaqe banimi respektive 93 m<sup>2</sup> dhe 28 m<sup>2</sup>, me adresë: \*\*\* Tiranë. Vlera e apartamentit 2.260.624 (dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e katër) lekë, me pagesë fillestare 40.000 (dyzet mijë) lekë, si dhe pagesë prej 900.000 (nëntëqind mijë) lekësh [nga të cilat 340.000 (treqind e dyzet mijë) lekë janë paguar për blerjen e garazhin]. Për apartamentin, nga momenti i lidhjes së kontratës me EKB-në, është likuiduar në total me këste vlera 1.239.580 (një milion e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë dhe vlera e kredisë për t'u paguar në vazhdim është 421.814 (katërqind e njëzet e një mijë e tetëqind e katërmëdhjetë) lekë. Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: marrë me kredi nga EKB-ja me afat shlyerje 25 vjet, interes 0%, me kësht mujor 5.800 (pesë mijë e tetëqind) lekë me Kontratën e Shitjes me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.11.1999, pasuria garazh paguar menjëherë. Pjesa takuese: 50%. Statusi i pronës: apartamenti figuron i regjistruar në emër të EKB-së dhe që prej vitit 1997 vijon në pronësi të këtij institucioni. Pasuria garazh nuk rezulton e regjistruar.

### Hetimi i kryer nga Komisioni

1.1 Subjekti i rivlerësimit, në Deklarimin Fillestar në vitin 2003, deklaroi se ka në pronësi ½ e pjesës takuese: “*Apartament 3+1 ndërtuar pas vitit 1990 me sip. 93 m<sup>2</sup>, me vlefë 2.1 milionë lekë*” dhe me burim krijimi: “... me kredi nga Enti Kombëtar i Banesave”, ndërsa në DPV-në e vitit 2004 deklaroi se ka në pronësi apartamentin e sipërcituar, si dhe një garazh, për të cilin ka paguar vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.

1.2 Dega Rajonale e EKB-së Tiranë, nëpërmjet vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2021, ka përcjellë dokumentacionin që ndodhet në dosjen e shtetasit A. A. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) duke konfirmuar pronësinë mbi apartamentin në cilësinë e palës shitëse deri në momentin që nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj do të shlyhet kësti i fundit. Lidhur me garazhin, EKB-ja informon se shtetasi A. A. e ka likuiduar vlerën me pagesë të menjëhershme duke përfutur edhe pronësinë mbi të.

1.2.1 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të EKB-së rezultoi se:

a) Bashkëshorti i subjektit është pajisur me Autorizim Strehimi nr. \*\*\* prot., datë 17.6.1996, nga Bashkia Tiranë për t'u trajtuar me strehim nëpërmjet EKB-së në një apartament banimi me strukturë 3+1 dhe garazh në rrugën “\*\*\*\*”, shkalla nr.\*\*\*, banesa nr. \*\*\*. Ky autorizim është miratuar në zbatim të pikës 6 të VKM-së nr. 530, datë 17.10.1994, “Për mënyrën e ndarjes së apartamenteve të ndërtruara nga Enti Kombëtar i Banesave”, i ndryshuar. Shtetasi A. A. ka përfutur statusin e të pastrehut me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.9.1997, të Këshillit Bashkiak sipas vërtetimit nr. prot.\*\*\*, datë 10.11.1997, të Bashkisë Tiranë.

b) Ndërmjet Degës Rajonale të EKB-së Tiranë dhe bashkëshortit të subjektit është lidhur më 25.4.1997 kontrata e përkohshme (pa noter) që shërbente si garanci për shitjen e apartamentit të banimit me strukturë 3+1 dhe për garazhin në pallatin që ishte në ndërtim e sipër.

Sipas nenit 5 të kësaj kontrate blerësit i ngarkohej paraprakisht kryerja e pagesës në vlerën 40.000 (dyzet mijë) lekë si paradhënie për banesën në ndërtim. Kjo vlerë i është paguar EKB-së nga bashkëshorti i subjektit me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 25.4.1997, me përshkrimin “kontratë provizore”.

c) Në datën 28.2.1998 është lidhura Kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., për shitjen e garazhit me sip. 28.39 m<sup>2</sup>, me vlerë 328.862 (treqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë së bashku me koston 4% si taksë e EKB-së për pagesën e shpenzimeve operationale në shumën 11.908 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetë) lekë, të paguara jashtë zyrës së noterisë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 19.8.1997, në emër të EKB-së. Sipas kësaj kontrate shitësi i dorëzon blerësit garazhin në datën 28.2.1998, duke u zhveshur nga e drejta e pronësisë.

ç) Në vijim është nënshkruar Kontrata e Shitjes me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.11.1999, ndërmjet subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit të saj dhe Degës Rajonale të EKB-së Tiranë për apartamentin e banimit me vlerë 2.260.624 (dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e katër) lekë, me këst mujor 5.800 (pesë mijë e tetëqind) lekë dhe interes 0%. Në zbatim të VKM-së nr. 291, datë 21.6.1994, “Për kriteret e vlerësimit të apartamenteve që ndërtohen me fonde shtetërore”, i ndryshuar, duke qenë se bashkëshorti i subjektit ka statusin e të pastrehut e ka përfutur këtë apartament me afat shlyerje të vlerës deri në 25 vjet.

1.3 Subjekti i rivlerësimit deklaron në Deklaratën *Vetting* pagesën fillestare në vlerën 40.000 (dyzet mijë) lekë për apartamentin dhe pagesën prej 900.000 (nëntëqind mijë) lekësh, ku përfshihet vlera e garazhit 340.000 (treqind e dyzet mijë) lekë, si dhe likuidimi në total me këste të vlerës 1.239.580 (një milion e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë.

1.3.1 Subjekti i rivlerësimit, në deklarinimin fillestar të vitit 2003 deklaron vetëm vlerën totale të apartamentit 2.100.000 (dy milionë e njëqind mijë) lekë si detyrim pagese ndaj EKB-së, ndërsa deklaron për herë të parë pagesën e garazhit në shumën 300.000 (treqind mijë) lekë në DPV-në e vitit 2004 dhe në DPV-në e vitit 2016 likuidimin në total me këste të vlerës 1.239.580 (një milion e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë.

1.3.2 Referuar Kontratës së Shitjes me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.11.1999, rezulton se: (a) vlera e apartamentit është 2.260.624 (dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e katër) lekë; (b) vlera e mbetur e detyrimit të kredisë për t’u paguar është 1.605.814 (një milion e gjashtëqind e pesë mijë e tetëqind e katërmëdhjetë) lekë; (c) subjekti ka likuiduar shumën e kësteve deri në datën 2.7.1999 prej 55.580 (pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë; (ç) afati i mbetur i shlyerjes së kredisë është 278 muaj nga 300 muaj në total; (d) kësti mujor është 5.800 (pesë mijë e tetëqind) lekë për periudhën e mbetur të kredisë dhe interesi i aplikuar është 0%.

1.3.3 Në kontratën e sipërcituar specifikohet se blerësi ka paguar në vitin 1997 (sipas mandatarkëtimin për muajt prill dhe gusht), për këtë apartament, shumën 639.230 (gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë) lekë e cila përfshin: (a) vlerën 553.752 (pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë si pagesë fillestare të kontratës provizore; (b) vlerën 85.478 (tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë si shpenzime operationale në ngarkim të EKB-së.

1.3.4 Sipas vërtetimit nr. \*\*\*, datë 27.10.2016, të EKB-së, subjekti i rivlerësimit, nga momenti i lidhjes së kontratës së shitjes me kusht të apartamentit deri në vitin 2016, ka paguar me këste në total vlerën 1.239.580 (një milion e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë dhe detyrimi i mbetur është në vlerën 421.814 (katërqind e njëzet e një mijë e tetëqind e katërmëdhjetë) lekë.

1.3.5 Në Kontratën e Shitjes me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.11.1999, përcaktohet edhe vlera e paguar në mënyrë të menjëhershme për garazhin në vlerën 340.770 (treqind e dyzet mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) lekë, ndërsa sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 19.8.1997, është arkëtuar vlera 328.862 (treqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy). Referuar formularit të llogaritjes së çmimit nr. 10, diferenca ndërmjet vlerave të mësipërme prej 12.721 (dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet e një) lekë është pagesa prej 4% e shpenzimeve operationale. Në analizën financiare është përfshirë vlera totale prej 980.000 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë paguar në vitin 1997, përkatësisht për apartamentin në vlerën 639.230 (gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë) lekë dhe për garazhin në vlerën 340.770 (treqind e dyzet mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) lekë.

1.3.6 Subjekti i rivlerësimit nuk deklaron në Deklaratën *Vetting* dhe as në DPV-të e viteve 2003-2004 burimin e të ardhurave që ka përdorur për kryerjen e pagesave për këtë pasuri në vitin 1997.

1.3.7 Subjekti i rivlerësimit deklaron në pyetësorin standard<sup>1</sup> se burimi i këtyre shpenzimeve është nga kursimet familjare ndër vite, të mbledhura nga paga e subjektit të rivlerësimit bashkë me pagën+dieta e bashkëshortit me detyrë ushtarak në Gardë, si rrjedhojë e jetesës në shtëpinë e prindërve me ekonomi të përbashkët.

1.3.8 Komisioni ka kryer analizën financiare deri në muajin gusht të vitit 1997, sipas të ardhurave të deklaruara dhe të dokumentuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, ku rezultoi se janë në pamundësi financiare në vlerën -271.427 (minus dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e njëzet e shtatë) lekë për të përballuar në vitin 1997 pagesën në total të vlerës prej 980.000 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekësh.

1.4 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri rezultoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në pamundësi financiare në vitin 1997 për kryerjen e pagesave të këstit të apartamentit dhe shlyerjen e vlerës së garazhit në shumën -271.427 (minus dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e njëzet e shtatë) lekë.

1.4.1 Subjektit të rivlerësimit iu kërkua të shpjegojë për Komisionin lidhur me statusin e pasurisë garazh dhe shkaqet e mosregjistrimit të kësaj pasurie në emër të subjektit dhe bashkëshortit.

1.4.2 Pasuria apartament duket se është përfitur sipas statusit “i pastrehë”, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë qenë bashkëpronarë në një pasuri tjetër apartament të trajtuar më poshtë.

1.4.3 Pasuritë apartament banimi me sip. 93 m<sup>2</sup> dhe garazh me sip. 28 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, apartamenti \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë, janë dhënë me qira në vijim (deklaruar nga subjekti) çka do të përforcojë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka përfitur në mënyrë të padrejtë këtë pasuri dhe se është përdorur prej saj për qëllime tregtare dhe jo për banim.

1.5 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit lidhur me këtë pasuri.

1.6 Subjekti i rivlerësimit, në vijim të barrës së provës, ka shpjeguar se: “*Lidhur me mosjustifikimin e shumës prej 271.497 lekësh, siç e kam përmendur, bashkëshorti im që pas diplomimit dhe deri daljes në reformë ka qenë efektiv i Gardës së Republikës, ku ka punuar edhe në Drejtorinë e Ruajtjes së Personaliteteve me Presidentin dhe Kryeministrin. Ka marrë, për shkak të detyrës trajtim me ushqim, veshje, dieta. Praktikisht, pothuajse s’e shikonim fare për shkak të detyrës. Bëj me dije se jo vetëm rroga e tij mbetej e paprekur, por edhe ushqimet vinin në shtëpi, edhe një pjesë e trajtimit për veshjen vinte në shtëpi. Në vitet në vijim, trajtimi*

<sup>1</sup>Shihni përgjigjen e pyetjes 9 në pyetësorin standard të datës 13.2.2020.

*financiar është rritur dhe kërkoj të llogariten gjithë të ardhurat, bazuar jo vetëm te paga e bashkëshortit, por gjithë të ardhurat e tij nga puna”.*

1.6.1 Për të provuar të ardhurat nga paga dhe trajtimin e përfituar nga bashkëshorti, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur si dokument vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 12.8.2021, të Gardës së Republikës së Shqipërisë, si dhe vërtetimin e datës 19.8.2021, të lëshuar nga Institucioni i Presidentit të Republikës lidhur me dieta të përfituara prej tij.

1.7 Për sa i përket statusit të pasurisë garazh të likuiduar me pagesë të menjëhershme dhe shkaqeve të mosregjistrimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“Nuk ka qenë mungesa e dëshirës për ta regjistruar, por na është thënë që nëse nuk regjistrohet apartamenti në pronësinë tonë, as garazhi (send aksesori) s’mund të regjistrohet”.*

1.8 Lidhur me gjetjen e Komisionit mbi përfitimet e kësaj pasurie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, subjekti i rivlerësimit sqaron se në çastin që janë trajtuan si të pastrehë, ligjërish nuk kishin në pronësi pasuri të paluajtshme. Sipas subjektit, pasuria apartament 3+1 dhe garazhi janë përfituar sipas ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, *“Për kontributin e shtetit në familjet e pastreha”* dhe pengesa ligjore e parashikuar në pikën 4 të nenit 12 nuk ekziston.

1.9 Lidhur me gjetjen e Komisionit mbi përdorimin e kësaj pasurie për qëllime tregtare (qiradhënie) dhe jo për banim, subjekti i rivlerësimit argumenton se: *“Dhënia me qira u bë për shkak të joshjes së parave, por edhe për shkak se isha me fëmijë të vogël dhe bashkëshorti pothuaj nuk vinte në banesë për shkak të punës dhe më duhej ndihma e prindërve. Ligji nuk ka pasur ndonjë ndalim për të dhënë sendin e përfituar me kredi, me qira. Unë s’mund ta dija, pa e marrë shtëpinë, se do ta jepja me qira”.*

1.9.1 Subjekti ka bashkëlidhur si dokument provues një foto të njoftimit të publikuar në datën 16.6.1998 në gazetën *“\*\*\*”*, ku reklamohet apartamenti për t’u lëshuar me qira.

1.10 Komisioni ka marrë në konsideratë provat e reja të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për përfitimin e trajtimit ushqimor dhe uniformën civile nga statusi i oficerit të bashkëshortit, duke mos llogaritur shpenzime jetike për bashkëshortin për periudhën kohore 1995 – 2006. Në vijim të rishikimit të analizës financiare deri në muajin gusht të vitit 1997 rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mundësi financiare për të blerë pasurinë në vlerën 980.000 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë për blerjen e pasurive të deklaruara.

1.11 Lidhur me shpjegimin e dhënë nga subjekti për arsyen e mosregjistrimit të pasurisë garazh, Komisioni gjykon se në referim të Kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.2.1998, të nënshkruar me EKB-në, kjo pasuri është blerë me pagesë të menjëhershme dhe EKB-ja është zhveshur nga e drejta pronësisë. Pra, subjekti nuk ka pasur pengesë ligjore për regjistrimin e pronësisë garazh dhe kjo situatë e vendos në kushtet e një deklarimi të pasaktë.

1.12 Në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, rezultoi se në vitin e pajisjes me autorizim strehimi nga Bashkia Tiranë, subjekti dhe bashkëshorti, në përmbushje të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, *“Për kontributin e shtetit në familjet e pastreha”*, nuk figuronin me pasuri në pronësi, por Komisioni krijon bindjen se veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, të cilët kanë hequr dorë nga një pasuri tjetër ku ishin bashkëpronarë, janë kryer me qëllim përfitimin e statusit *“të pastrehë”*. Kjo edhe për faktin se nga hetimi rezultoi se kjo pasuri është dhënë me qira që në momentin fillestar kur është marrë në përdorim dhe nuk është shfrytëzuar nga subjekti për strehim. Përfitimi nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti në vitin 1993 të bashkëpronësisë në një pasuri tjetër (atë të prindërve të subjektit të rivlerësimit) duket legjitime dhe në raport të drejtë më kërkesat e kohës (legjislacionin në fuqi në raport me sipërfaqen, numrin e bashkëpronarëve dhe situatën reale të banimit). Përpjekjet e tyre për të hequr dorë nga një pasuri ku ishin bashkëpronarë si dhe mosregjistrimi i asaj pasurie ende në emër të subjektit të rivlerësimit krijojnë bindjen se janë veprime të qëllimshme të kryera pikërisht për legjitimitetin e tyre në vitin 1997 për të përfituar edhe një pasuri tjetër publike. Kjo situatë, në vlerësim të

trupit gjykues, e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

**2. Shtesë apartamenti** me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në bazë të vërtetimit të pronësisë nr. \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*”, aplikimi për legalizimin e të cilit është kryer nga nëna e subjektit S. A., por në momentin e legalizimit ajo kishte ndërruar jetë. Si rrjedhojë, bazuar në dëshminë e trashëgimisë, u regjistrua në ZVRPP-në Tiranë në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Burimi i krijimit sipas Deklaratës *Vetting*: shpenzimet janë përballuar nga qiraja e apartamentit bashkëshortor me kredi (shoqëria “\*\*\*\*”) 600 (gjashtëqind) USD/muaj dhe kursimet familjare. Pjesa takuese: 100% në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

2.1 Shtesa anësore 7 kate është ndërtuar në objektin ekzistues, ku është trajtuar me strehim nëpërmjet EKB-së subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti. Në këtë objekt banimi secili prej banorëve ka investuar për ndërtimin e një shtese në apartamentet respektive.

2.2 Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë deklaruar se kanë investuar për ndërtimin e kësaj shtese në vitet 1999 – 2001, por aplikimi për procedurën e legalizimit është regjistruar në emër të nënës së subjektit S. A. në vitin 2006. Sipas subjektit të rivlerësimit, arsyeja e këtij veprimi ishte në respektim të dëshirës së nënës së saj për ta pasur në trashëgimi djali i subjektit të rivlerësimit.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

2.3 ASHK-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2020, konfirmon për Komisionin se subjekti i rivlerësimit është pajisur me leje legalizimi për ndërtimin e kësaj pasurie dhe praktika i është përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2001, ish-ZVRPP-së Tiranë për regjistrim.

2.3.1 Gjithashtu, ASHK-ja, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2021, ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacionin e plotë të disponuar në dosje për procedurën e legalizimit.

2.3.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ASHK-së rezulton se:

2.3.3 Formulari i vetëdeklarimit për legalizimin e shtesës anësore për banim 7-kate në favor të banorëve të pallatit në rrugën “\*\*\*\*” është depozituar pranë ALUIZNI-it në datën 10.10.2006. Ky formular është nënshkruar nga banorët e pallatit, ndër ta edhe nëna e subjektit të rivlerësimit S. A..

2.4 Në datën 20.3.2009 është hartuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-it Tiranë procesverbali i konstatimit për objektin e kombinuar të deklaruar me vetëdeklarimin nr. \*\*\*, datë 10.10.2006, nga banorët e pallatit në rrugën “\*\*\*\*”, me sipërfaqe të sheshndërtimit 86.3 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e përgjithshme ndërtimi 545.3 m<sup>2</sup> dhe 7 kate, nga të cilat 6 kate banimi.

2.5 Sipas certifikatës së vdekjes, vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, nëna S. A. ka ndërruar jetë në datën 14.7.2007.

2.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.6.2010, ka pranuar lëshimin e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësit Xh. dhe S. A. (prindërit), duke përcaktuar si trashëgimtare të vetme ligjore subjektin e rivlerësimit.

2.7 ALUIZNI ka konfirmuar legalizimin e shtesës me akt kualifikimin nr. \*\*\*, datë 20.3.2009.

2.7.1 Nëpërmjet VKM-së nr. 1134, datë 18.11.2009, “Për kalimin e pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”, i ndryshuar, është miratuar, ndër të tjera, edhe parcela ndërtimore ku ndodhet objekti ekzistues.

2.7.2 Në zbatim të aktit nënligjor të mësipërm është nënshkruar Kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.3.2011, për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore me sip. 86.3 m<sup>2</sup>, me palë shitëse ALUIZNI-in dhe palë blerëse banorët e pallatit, ku përfshihet edhe emri i subjektit të rivlerësimit me vlerë parcele ndërtimore 305.642,80 (treqind e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet

e dy e tetëdhjetë qindarka) lekë dhe taksë ndikimi në infrastrukturë në vlerën 300.250 (treqind mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.

2.7.3 Këto vlera janë pjesëtuar dhe përlllogaritur sipas pjesës takuese për 7 familje, ku konkretisht shtetasja S. A. duhet të paguante vlerën 41.158,5 (dyzet e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë e pesë qindarka) lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe 35.803,6 (tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e tre e gjashtë qindarka) lekë për vlerën e parcelës ndërtimore.

2.7.4 Sipas faturave të arkëtimit të “Credins Bank”, këto vlera janë paguar në datat 21.5.2009 dhe 1.4.2010 nga njëri prej banorëve të pallatit, shtetasi J. M. për llogari të të gjitha familjeve të përfshira në këtë proces.

2.7.5 Në datën 26.4.2011 janë hartuar planimetritë e shtesave sipas apartamenteve respektive, ku në emër të subjektit të rivlerësimit figurojnë shtesë me sip. 87.2 m<sup>2</sup>.

2.7.6 Në vijim është miratuar Leja e Legalizimit nr. \*\*\*, datë 30.6.2011, për objektin shtesë anësore 7 kate, e kombinuar në godinën ekzistuese 5 kate, me sipërfaqe parcele ndërtimore 86.3 m<sup>2</sup>, në emër të banorëve posedues, ndër ta edhe emri i subjektit të rivlerësimit.

2.7.7 Sipas certifikatës së pronësisë, kjo pasuri është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit në datën 13.1.2012.

## **2.8 Burimi i të ardhurave të përdorura për ndërtimin e kësaj pasurie dhe vlera e saj**

2.8.1 Subjekti i rivlerësimit deklaron në Deklaratën *Vetting* se kjo pasuri është ndërtuar me burim të ardhurat nga qiraja e apartamentit bashkëshortor, dhënë shoqërisë farmaceutike “\*\*\*\*” me 600 (gjashtëqind) USD/muaj, si dhe me kursimet familjare si rrjedhojë e jetesës me prindërit me ekonomi të përbashkët.

2.8.2 Sipas formularit të vetëdeklarimit rezulton se kjo shtesë është deklaruar pranë ALUIZNI-it në datën 10.10.2006, por në këtë formular nuk specifikohet periudha kohore e ndërtimit dhe as vlera që ka kushtuar ky investim.

2.9 Referuar përgjigjes së dhënë nga subjekti i rivlerësimit<sup>2</sup> në pyetësin e datës 2.6.2021, ndërtimi i kësaj shtese ka filluar në vitin 1999 dhe ka përfunduar në vitin 2001.

2.9.1 Në këtë periudhë kohore subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kishin marrëdhënie kontraktuale qiradhënieje me shoqërinë farmaceutike “\*\*\*\*”, me këst mujor 600 USD me kohëzgjatje 15.8.1998 – 15.8.2001, por për të ardhurat e përfituara nga qiraja nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit në total në vlerën 21.600 USD për periudhën 1998 – 2001 nuk është paguar detyrimi tatimor në burim. Këto të ardhura janë trajtuar më poshtë në këtë relacion.

### **Vlera totale e investimit**

2.10 Subjekti i rivlerësimit nuk deklaron në Deklaratën *Vetting* vlerën totale të shpenzuar për ndërtimin e kësaj pasurie. E pyetur lidhur me koston totale të këtij investimi, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësit të datës 2.6.2021, sqaron për Komisionin: “Sipas preventivit të shtesës me sip. 87.20 m<sup>2</sup>, me Certifikatë nr. \*\*\* dhe nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, i regjistruar në ZVRPP-në Tiranë rezulton se vlera totale e tij është 2.814.310 lekë. Në këtë preventiv janë përfshirë këto zëra punimesh: 1-punime karabin;; 2-mur tulle 25 cm dhe 12 cm; 3-punime suvatimesh e shtresash; 4-punime izolimi; 5-punim hidrosanitar; 6-punime eletrike; 7-punime të ndryshme”.

2.10.1 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur pyetësit dokumentet vijuese: kopjen e preventivimit të zërave të punimeve nga Ing. A. Sh.; licencën e Ing. A. Sh.; vërtetimin datë 4.6.2021 të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; faturën proforme nr. \*\*\*, datë 8.6.2021, të shoqërisë “\*\*\*\*”; si dhe vërtetimin datë 9.6.2021 nga shtetasi S. C..

<sup>2</sup>Përgjigja nr.1 e pyetësit të datës 2.6.2021.



2.11 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se:

a) Preventivi i shtesës është hartuar nga Ing. A. Sh., i cili është i pajisur me licencë për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit. Sipas preventivit të zërave të punimeve, vlera totale e investimit për ndërtimin e shtesës ka kushtuar 2.814.310 (dy milionë e tetëqind e katërbëdhjetë mijë e treqind e dhjetë) lekë. Në këtë vlerë janë përfshirë, krahas çmimit të materialit dhe punëtorisë për transport dhe vendosjen në objekt, edhe pjesa takuese e vlerës për ndërtimin e karabinasë dhe izolimit të tarracës së objektit.

Sipas dy vërtetimeve të mësipërme dhe faturës, kompletimi i brendshëm i shtesës me dyer, pllaka dhe dritare është bërë në vitin 2001. Konkretisht, vlera e materialeve të ndërtimit të blera nga shtetasi A. A. është në total 674.900 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind) lekë dhe është e përfshirë në preventiv e shpërndarë sipas kategorisë së zërave të punimeve përkatëse.

b) Referuar deklaramit të subjektit të rivlerësimit që kjo pasuri është ndërtuar në harkun vjetor 1999 – 2001, por pa u specifikuar gjendja strukturore e kësaj pasurie (fazat e ndërtimeve) gjatë këtyre viteve, nëse do të bazohet tek kostot mesatare të ndërtimit të banesave të EKB-së për këto vite, rezulton se nga llogaritja së bashku e kostos së viteve 1999 – 2001 (përkatësisht 20.033 lekë/m<sup>2</sup> viti 1999, 24.780 lekë/m<sup>2</sup> viti 2000 dhe 28.641 lekë/m<sup>2</sup> viti 2001) vlera mesatare e investimit/ndërtimit të kësaj pasurie me sip. 87.2 m<sup>2</sup> është 2.135.062,66 (dy milionë e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e dy e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

2.12 Në vijim, Komisioni ka përgatitur analizën financiare kumulative, duke marrë në konsideratë vlerën e investimit të deklaruar nga subjekti në vlerën 2.814.310 (dy milionë e tetëqind e katërbëdhjetë mijë e treqind e dhjetë) lekë.

<b>Analizë e viteve 1999- 2001</b>	<b>Vlera</b>
Të ardhura të dokumentuara	2.321.670
Shpenzime jetese	1.293.461
Shpenzime mobilimi	412.650
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>615.559</b>
Ndërtimi i apartamentit me sip. 87.2 m <sup>2</sup>	2.814.310
Pasuri ekzistuese (apartament me sip. 93 m <sup>2</sup> , me kredi nga Enti/automjet tip "Golf")	2.121.394
Detyrime (kredia te Enti)	1.501.235
<b>Pasuri Neto</b>	<b>3.434.469</b>
<b>Rezultati NETO</b>	<b>-2.818.910</b>

2.12.1 Në këtë analizë nuk janë përfshirë të ardhurat nga qiraja në vlerën 14.400 (katërbëdhjetë mijë e katërqind) USD për periudhën 1999 – 2001, për të cilat nuk rezulton se janë paguar detyrimet tatimore sipas kërkesave të nenit d pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

2.13 Në përfundim konstatohet se:

a) *Kjo pasuri është një ndërtim pa leje dhe deklarimi për regjistrimin e saj nga nëna e subjektit duket se është bërë për të shmangur këtë veprim të kryer nga subjekti i rivlerësimit me cilësinë e gjyqtarit.*

b) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në Deklaratën Vetting dhe as në DPV vlerën totale të investimit për ndërtimin e kësaj pasurie. Referuar vlerës së deklaruar gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare me burime të ligjshme për të ndërtuar apartamentin me sip. 87.2 m<sup>2</sup>.*

c) *Të ardhurat nga qiraja, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 14.400 (katërbëdhjetë mijë e katërqind) USD, të përdorura për ndërtimin/investimin e kësaj pasurie nuk janë në përputhje me kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, prandaj deri në këtë moment nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare si burim për këtë pasuri.*

2.14 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me këtë pasuri.

2.15 Subjekti i rivlerësimit, në vlerësim të barrës së provës, shpjegon se ligjshmëria e pasurisë lidhet me burimin e krijimit dhe jo me pagesën tatimore mbi këtë të ardhur duke vijuar argumentin se në zbatim të legjislacionit tatimor ka qenë detyrim i personit juridik të paguante tatimin, duke u shprehur se: *“Kemi deklaruar se shtesën e apartamentit e kemi ndërtuar me të ardhura nga qiraja e apartamentit. Është dhënë me qira në persona juridikë. Sipas ligjit të kohës edhe sot madje, tatimi duhet të ishte paguar nga personi juridik. Fakti që ky person juridik nuk e ka paguar s’mund dhe s’duhet të më penalizojë sot. Ne as kishim përse të kujdeseshim nëse ishte paguar apo jo tatimi pasi ligjërisht nuk na takonte”*.

2.16 Në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit për të ardhurat nga qiraja, trupi gjykues arrin në përfundimin se në periudhën kohore 1999 – 2001 kur ekzistonte marrëdhënia e qirasë, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ngarkohej përfituesi i të ardhurave nga qiraja që të paguante tatimin mbi të ardhurat personale. Pra, ka qenë detyrim i subjektit që të paguante tatimin për të ardhurat nga qiradhënia. Njëkohësisht nga mandatpagesat e vëna në dispozicion nga subjekti evidentohet se të ardhurat mujore të qirasë janë përfituar në vlerën *bruto* sipas specifikimit në kontratë. Në gjykimin e trupit gjykues burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie nuk përmbushin kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe se subjekti ka qenë në dijeni të mospagimit prej saj të detyrimeve tatimore përkatëse (duke përfituar shumën e plotë). Këto të ardhura nuk plotësojnë kushtet formale të ligjshmërisë së krijimit të kërkuara nga Kushtetuta dhe ligji.

2.17 Lidhur me situatën negative financiare të rezultuar gjatë hetimit administrativ për krijimin e kësaj pasurie në vlerën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit gjatë pyetësorëve, Komisioni ka marrë në konsideratë si provë të re dokumentet e përcjella nga subjekti i rivlerësimit për trajtimin ushqimor dhe uniformën e bashkëshortit për periudhën 1993 – 2013, duke zbritur shpenzimet për bashkëshortin nga shpenzimet jetike të familjes. Në vijim të rishikimit të analizës rezulton se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare me burime të ligjshme për të ndërtuar këtë pasuri në vlerën -1.849.718 (minus një milion e tetëqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

2.18 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie nuk kënaqin kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe se subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni të mospagimit të këtyre detyrimeve tatimore.

2.19 Gjithashtu, në vlerësim të trupit gjykues, ky ndërtim informal është kryer në vijim të të drejtave të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, si banorë të apartamentit me sip. 93 m<sup>2</sup> + garazh me sip. 28 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, shkalla \*\*\*, apartamenti \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë, të trajtuar më lart e të përfituar në mënyrë të padrejtë prej tyre. Kështu, mosdeklarimi i kësaj shtese prej tyre, por nga nëna e subjektit të rivlerësimit, të cilën nuk e lidhte asgjë me këtë pasuri, krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ka dashur ta shmangë këtë deklaram.

**3. Përfitim të ardhurash nga dhënia me qira e apartamentit 3+1** në periudha të ndryshme nga viti 1998 deri më 1.7.2015, pa specifikuar vlerën në total, si dhe detyrimin kontraktual të një qiramarrësi në shumën 130.000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë për mospagim të qirasë, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën *Vetting*.

3.1 Referuar kontratave të qiradhënies të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit konstatohet:

a) Kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.7.1998, me qiramarrës shoqërinë “\*\*\*\*”, me afat qiradhënieje 2-vjeçar (15.8.1998 – 15.8.2000) dhe qira mujore 600 (gjashtëqind) USD; Kontratë nr. \*\*\* rep., datë 17.11.2000, me qiramarrës shoqërinë “\*\*\*\*”, me afat qiradhënieje

1-vjeçar (15.8.2000 - 15.8.2001) dhe qira mujore 600 (gjashtëqind) USD; në periudhën 1998 – 2001 subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga shoqëria “\*\*\*\*” në total vlerën 21.600 (njëzet e një mijë e gjashtëqind) USD të ardhura me burim nga qiradhënia. Sipas procesverbaleve dhe mandateve të lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” rezulton kryerja e pagesave të qirasë për periudhën 1.1.1999 - 12.12.2000, në total në vlerën 14.400 (katërmbëdhjetë mijë e katërqind) USD.

b) Kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.1.2007 me qiramarrës shtetasen amerikane L. J. G., me afat qiradhënieje 1-vjeçar (1.8.2006 - 31.7.2007) dhe qira mujore 250 (dyqind e pesëdhjetë) USD; nga kontrata e qirasë me shtetasen L. J. G. me afat 1-vjeçar për periudhën 2006 - 2007 subjekti i rivlerësimit ka përfituar në total shumën 3.000 (tre mijë) USD, me qira mujore 250 (dyqind e pesëdhjetë) USD. Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore rezulton se subjekti ka deklaruar vlera qiraje të ndryshme nga kontrata e mësipërme, konkretisht 500 (pesëqind) USD/muaj për vitin 2006 dhe 450 (katërqind e pesëdhjetë) USD/muaj për vitin 2007 me fitim vjetor 5.400 (pesë mijë e katërqind) USD.

c) Kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.1.2015, me qiramarrës shtetasit A. dhe S. K., me afat qiradhënieje 1-vjeçar (1.8.2014 - 31.7.2015) dhe qira mujore 30.000 (tridhjetë mijë) lekë/muaj dhe Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.7.2015.

3.1.1 Në total, duke u bazuar në kontratat e qiradhënies, subjekti i rivlerësimit ka përfituar shumat 24.600 (njëzet e katër mijë e gjashtëqind) USD dhe 230.000 (dyqind e tridhjetë mijë) lekë.

3.2 Komision ka kryer një hetim të plotë në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga qiraja për kontratat më lart, nga ku DRT-ja<sup>3</sup> informon se:

a) për Kontratat e Qirasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.7.1998; nr. \*\*\*, datë 17.11.2000, me qiramarrës shoqërinë “\*\*\*\*”; si dhe nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.1.2007, me qiramarrës shtetasen L. J. G., nuk rezulton të jetë paguar tatim në burim mbi të ardhurat e përfituara.

b) Për Kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.1.2015 DPT-ja ka përcjellë listën e pagesave të tatimit në burim mbi qiratë e kryera gjatë viteve 2015 - 2019 nga shtetasi A. K. si person fizik i regjistruar me NIPT: \*\*\*.

3.3 Nga verifikimi në sistemin *online* të QKB-së konstatohet se ky shtetas është i regjistruar më datë 11.8.2008, si person fizik për ushtrimin e një biznesi “\*\*\*\*” me status aktiv dhe referuar ekstraktit historik adresa e ushtrimit të aktivitetit ka ndryshuar disa herë. Konstatohet se për vitet 2014 - 2015 adresa e ushtrimit të aktivitetit tregtar ka pasur një vendndodhje tjetër nga adresa e apartamentit të marrë me qira nga ky shtetas në këtë periudhë.

3.3.1 Kontrata e qiramarrjes së apartamentit me subjektin e rivlerësimit është nënshkruar nga shtetasi A. K. dhe bashkëshortja e tij si individ, ndërsa pagesat pranë tatimeve janë kryer për ambientet me qira të aktivitetit tregtar.

3.4 Nga hetimi rezultoi se detyrimi tatimor në burim për qiratë është paguar nga ky shtetas si person fizik për ambientet e ushtrimit të aktivitetit tregtar, i cili nuk është i njëjtë me atë të dhënë me qira nga subjekti i rivlerësimit, por një ambient tjetër.

3.5 Subjekti i rivlerësimit, e pyetur nga Komisioni lidhur me pagesën për detyrimet tatimore, sqaron<sup>4</sup>: *“Për sa i përket faturave që nuk disponoj të shumë viteve më përpara, jam interesuar pranë ‘Credins Bank’ dhe rezultoi se bashkëshorti im A. A., i cili ka kryer pagesat nuk ka pasur numër llogarie në këtë bankë dhe ka paguar cash dhe, si rrjedhojë, duhet të kërkohet në arshivën e bankës nga ana e tyre për të nxjerrë dokumentet, çka sipas tyre është e pamundur. Dokumentet që unë disponoj po i paraqes bashkangjitur këtij e-maili”.*

3.6 Në përfundim konstatohet se për të ardhurat e përfituara nga qiraja sipas kontratave nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për vitet 1998 – 2001, 2006 - 2007 dhe 2014 - 2015.

<sup>3</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2021.

<sup>4</sup>Pyetja nr. 2 e pyetësorit të datës 2.3.2020.

Për rrjedhojë, të ardhurat nga qiraja nuk do të konsiderohen si burim dhe nuk do të përfshihen në analizë financiare deri në këtë moment.

3.7 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

3.8 Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime lidhur me këtë pikë të barrës së provës, por nëse vlerësohen shpjegimet dhe qëndrimi i dhënë prej saj mbi të ardhurat nga qiratë për periudhën 1998 – 2001, të trajtuara në pikën 2 lidhur me të ardhurat për ndërtimin e shtesës anësore me sipërfaqe të sheshndërtimit 86.3 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”. Në qëndrimin e saj, subjekti ka deklaruar se ligjërish nuk u takonte ta paguanin, duke cituar dispozitat e ligjit të kohës nr. 8438, datë 31.12.1998 (i ndryshuar), dhe parashikimit të tij në nenin 33 “Mbajtja e tatimit mbi të ardhurat” dhe se nuk kanë pasur detyrim të kujdeseshin për ta provuar atë.

3.9 Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të rezultuara, si dhe legjislacionit në fuqi, trupi gjykues vlerëson se legjislacioni përkatës ka ndryshuar pas vitit 2001 (në dhjetor) duke përcaktuar se tatimi mbi të ardhurat nga kontratat e qirasë mbahet në burim kur qiradhënësi është person juridik/fizik i pajisur me nipt. Në këtë këndvështrim, subjekti i rivlerësimit nuk është kujdesur për t’i provuar Komisionit se ka përfituar vlerën *neto* apo *bruto* apo se nuk ka qenë në dijeni se qiradhënësi nuk ka përmbushur detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara prej saj, madje as në kontratë nuk ka pasur ndonjë përcaktim të tillë mbi detyrimin për derdhjen e tatimit apo përfitimin nga qiradhënësi vetëm të vlerës *neto*.

3.10 Në përfundim, trupi gjykues ka vlerësuar se këto të ardhura, në çdo rast, nuk kanë afektuar analizën financiare për vitet 2003 – 2015, e cila rezulton me një balancë pozitive dhe se nuk janë përdorur në blerjen apo krijimin e ndonjë pasurie nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të duke arritur në konkluzionin se këto të ardhura edhe nëse nuk merren në konsideratë nuk sjellin asnjë nga pasojat e përcaktuara në pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**4. Të ardhura nga dhënia me qira e shtesës së pasurisë në periudha të ndryshme nga momenti i ndërtimit deri në vazhdim, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën *Vetting*, pa specifikuar vlerën në total, por vetëm qiranë mujore në vlerën 32.000 (tridhjetë e dy mijë) lekë.**

4.1 Referuar kontratave të qiradhënies, të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet:

a) Kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.10.2016, me qiramarrës shtetasin A. I. me afat qiradhënieje 3-mujor (1.10.2016 - 31.12.2016) dhe qira mujore 32.000 (tridhjetë e dy mijë) lekë. Për këtë periudhë 3-mujore në vitin 2016 subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga shtetasi Alket Islami të ardhura në total 96.000 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.

b) Kontratë qiradhënieje nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 20.4.2017, me palë qiramarrëse shtetasin A. I., me periudhë qiradhënieje 7-mujore (30.4.2017 - 30.12.2017) dhe qira mujore 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.

c) Kontratë qiradhënieje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.3.2019, me palë qiramarrëse shtetasin A. I., me periudhë qiradhënieje 17-mujore (1.1.2018 - 1.6.2019) dhe qira mujore 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.

ç) Kontratë qiradhënieje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.1.2020, me palë qiramarrëse shtetasin I. Gj., me periudhë qiradhënieje 1-vjeçare (1.11.2019 - 1.11.2020) dhe qira mujore 32.000 (tridhjetë e dy mijë) lekë.

4.1.1 Në total, duke u bazuar në kontratat e qiradhënies deri në periudhën e Deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka përfituar në total 96.000 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.

4.2 Komisioni ka kryer një hetim të plotë në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga qiraja. Gjatë hetimit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve<sup>5</sup> informon se subjekti i rivlerësimit rezultoi të regjistruar që nga data 5.4.2017 për përgjegjësinë tatimore në burim (tatim mbi qiranë).

a) Sipas të dhënave të DPT-së mbi vlerat në total të qirasë dhe tatimit mbi qiranë rezultoi se nga subjekti i rivlerësimit ka paguar për tatimin në burim për të ardhurat nga Kontrata e Qiradhënies nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.10.2016; nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.4.2017; nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.3.2019, me palë qiramarrëse A. I. dhe nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.1.2020, me palë qiramarrëse I. Gj..

b) Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit figuron i regjistruar në datën 9.6.2017 për përgjegjësinë tatimore, tatim në burim. Shtetasi A. A. ka paguar tatimin mbi qiranë për periudhën maj 2017.

4.3 Në përfundim konstatohet se:

a) Nga hetimi i kryer rezultoi se subjekti i rivlerësimit në vitin 2016 ka pasur marrëdhënie kontraktuale 3-mujore dhe ka përfituar në total shumën 96.000 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë. Këto të ardhura i janë nënshtruar detyrimit të tatimit në burim, si dhe janë marrë në konsideratë në analizën financiare të vitit 2016 në vlerën 96.000 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.

b) Nga hetimi nuk provohet që të jenë paguar detyrimet tatimore për qiratë e pretenduara të përfituara nga subjekti për periudhën 2012 – 2015. Deri në këtë moment këto të ardhura nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare.

4.4 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

4.5 Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime në vlerësim të kësaj barre prove, por nëse vlerësohen shpjegimet dhe qëndrimi i dhënë prej saj mbi të ardhurat nga qiratë të trajtuar në pikat 2 dhe 3 në këtë vendim, në qëndrimin e saj subjekti ka deklaruar se ligjërisht nuk u takonte ta paguanin, duke cituar dispozitat e ligjit të kohës nr. 8438, datë 31.12.1998, (i ndryshuar) dhe parashikimit të tij në nenin 33 “Mbajtja e tatimit mbi të ardhurat” dhe se nuk kanë pasur detyrim të kujdeseshin për ta provuar atë.

4.6 Në përfundim të hetimit administrativ, trupi gjyqës vlerëson se të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit me burim nga qiradhënia për periudhën 2012 – 2015 nuk janë konsideruar si burim dhe nuk janë përfshirë në analizë financiare, pasi nuk përmbushin kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, por arrin në konkluzionin se këto të ardhura edhe nëse nuk merren në konsideratë nuk sjellin asnjë nga pasojat e përcaktuara në pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**5. Apartament banimi** me sipërfaqe totale 72.60 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, apartamenti nr.\*\*\*, në pronësi të prindërve Xh. dhe S. A.. Nëna S. A., meqenëse subjekti ishte fëmijë i vetëm, në dokumentet e privatizimit e ka përfshirë si bashkëpronarë atë dhe bashkëshortin e saj, ndërkohë që subjekti isha shkëputur nga trangu familjar i tyre me martesë në vitin 1986, fakt ky i provuar nga Certifikata Familjare nr. \*\*\*, datë 15.10.2016, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia Bashkiake Nr. \*\*\* Tiranë. Në datën 5.6.1996 subjekti dhe bashkëshorti, në bazë të Kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol. i dhuruan pjesën e tyre të bashkëpronësisë prindërve të subjektit. Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: apartamenti është marrë nga shtetasi Xh. A. nga Fondi i Komitetit Ekzekutiv në vitin 1976 dhe është privatizuar në bazë të kontratës së shitjes me Ndërmarrjen Komunale të Banesave në datën 19.7.1993. Pjesa takuese: 50% Xh. A. dhe 50% S. A..

<sup>5</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2021.

5.1 Subjekti i rivlerësimit deklaron në deklarinimin fillestar të vitit 2003 e në vijim si adresë vendbanimi vendndodhjen e kësaj pasurie.

5.2 Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë qenë bashkëpronarë në këtë apartament. Në vijim, nëpërmjet Kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.6.1996, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i kanë dhuruar shtetasve Xh. dhe S. A. pjesën e tyre takuese në këtë pasuri pa kundërshpërblim, duke mos pasur më të drejtë bashkëpronësie mbi këtë apartament.

5.3 Më pas, shtetasi A. A. ka përfituar në datën 10.11.1997 statusin e të pastrehut duke përfituar edhe apartamentin e trajtuar në pikën 1 të vendimit me sip. 93 m<sup>2</sup> + garazh me sip. 28 m<sup>2</sup> + shtesë anësore me sip. 87.2 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, shkalla \*\*\*, apartamenti \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*. Sipas nenit 23 të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, i ndryshuar (aktualisht i shfuqizuar) në asnjë rast qytetari nuk mund të bëhet njëkohësisht pronar i dy banesave shtetërore.

5.4 ASHK-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2020, konfirmon për Komisionin se kjo pasuri është në bashkëpronësi të shtetasve Xh. dhe S. A., duke vënë në dispozicion dokumentacion e disponuar.

### **5.5 Nga shqyrtimi i dokumentacion të ASHK-së rezulton se:**

a) Në datën 19.7.1993 është nënshkruar kontrata e privatizimit të banesës me palë ish Ndërmarrjen Komunale të Banësive dhe qiramarrës shtetasin Xh. A.. Vlera e privatizimit prej 10.840 (dhjetë mijë e tetëqind e dyzet) lekësh është paguar menjëherë me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 19.7.1993. Njëkohësisht është nënshkruar edhe kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie me palë blerëse Xh. dhe S. A., A. A. dhe Kaçë Agolli.

b) Sipas kartelës së pasurisë rezulton se në vitin 1998 ky apartament ishte në bashkëpronësi ndërmjet subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit dhe prindërve të saj, ndërsa në vitin 2000 ky apartament figuron me bashkëpronarë prindërit e subjektit të rivlerësimit Xh. dhe S. A..

5.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.6.2010, ka pranuar lëshimin e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësit Xh. dhe S. A., duke përcaktuar si trashëgimtare të vetme ligjore subjektin e rivlerësimit, por subjekti nuk ka kryer procedurat për kalimin e pronësisë së kësaj pasurie në emër të saj, pasi në Deklaratën *Vetting* ka deklaruar se për arsye nostalgjie kjo pasuri figuron në emër të prindërve Xh. dhe S. A..

5.7 Në përfundim konstatohet se ky apartament është privatizuar në vitin 1993 dhe është regjistruar në pronësi të prindërve të subjektit të rivlerësimit, subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë hequr dorë nga kjo pasuri duke e dhuruar pjesën e tyre të bashkëpronësisë me qëllim vijimin e procedurave me EKB-në. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti janë trajtuar me strehim nëpërmjet EKB-së si përfitues nga statusi i të pastrehut, ndërkohë që ishin bashkëpronarë me prindërit e subjektit të rivlerësimit në këtë pasuri. Subjekti është pronar i pasurisë apartament banimi me sip. totale 72.60 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, qysh prej vitit 2010, por ende nuk e ka regjistruar këtë pasuri në emrin e saj.

5.8 Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se tërësia e veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit, regjistrimi i saj, si dhe e vlerësuar në raport me pasurinë apartament + garazh në rrugën “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, e vendosin atë në kushtet e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

**6. Shtesë anësore në proces legalizimi** me sip. 1.60m<sup>2</sup> + 3.30 m<sup>2</sup> në apartamentin në pronësi të prindërve të subjektit të rivlerësimit, e cila deklaron ndërtimin e një shtese anësore në banesën e prindërve, duke mos specifikuar periudhën kohore të ndërtimit, vlerën e investimit dhe mënyrën e investimit.

6.1 Në lidhje me këtë pasuri Komisioni kreu verifikime lidhur me deklarinimet e subjektit dhe vlerat përkatëse të investimit, si dhe dëgjoi shpjegimet e dhëna prej saj e në përfundim arrin në

konkluzionin se është një sipërfaqe e papërfillshme, për të cilën nuk u konstatuan problematika që mund të mbahen në konsideratë në lidhje me rivlerësimin e subjektit.

**7. Automjet tip “Volkswagen Golf”**, viti i prodhimit 1987, me targa \*\*\* sipas Kontratës së Shitblerjes së Automjetit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*, datë 26.11.2000, me vlerë 500.000 (pesëqind mijë) lekë, shitur me Kontratën e Shitjes nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 2.12.2006, me vlerë 160.000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Burimi i krijimit sipas deklaratës fillestare të vitit 2003: kursimet familjare.

7.1 Subjekti i rivlerësimit deklaron në Deklarimin Fillestar të vitit 2003 automjetin tip “Volkswagen Golf”, të blerë me kursimet familjare në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

7.2 Subjekti i rivlerësimit nuk deklaron në DPV-në e vitit 2006 vlerën e të ardhurave 160.000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë të përfituara nga shitja e këtij automjeti.

7.3 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2020, ka konfirmuar për Komisionin se automjeti me targa \*\*\* ka qenë i regjistruar në emër të shtetasit A. J. A. (i cili figuron me statusin “çregjistrim i përhershëm”), duke përcjellë edhe dosjen e automjetit.

7.4 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezulton:

7.4.1 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka blerë këtë automjet me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*, datë 26.11.2000, me palë shitëse shtetasin A. K., në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, e cila është paguar jashtë zyrës noteriale.

7.4.2 Sipas deklaratës doganore ky automjet është zhdoganuar më 2.11.2000, në Doganën Lezhë nga shtetasi A. K. dhe detyrimi doganor është paguar nga ky shtetas në vlerën 141.275 (njëqind e dyzet e një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

7.4.3 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka nënshkruar Kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.12.2006, për huadhënien e automjetit me targa \*\*\* shtetasit I. Q., pa afat dhe kundërshpërbim.

7.4.4 Në vijim është nënshkruar Kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.12.2006, me palë shitëse shtetasin A. A. dhe palë blerëse shtetasin I. Q. për automjetin e mësipërm në vlerën 160.000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, e cila është paguar jashtë zyrës noteriale.

7.5 Lidhur me situatën negative financiare të rezultuar gjatë hetimit administrativ për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni ka marrë në konsideratë si provë të re dokumentet e përcjella nga subjekti i rivlerësimit për trajtimin ushqimor dhe me uniform të bashkëshortit, duke zbritur shpenzimet për bashkëshortin nga shpenzimet jetike të familjes. Në vijim të rishikimit të analizës rezulton se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare me burime të ligjshme në vlerën -77.990 (shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë për krijimin e kësaj pasurie. Trupi gjykues nuk ka vlerësuar të konstatojë këtë shumë si mangësi, por vetëm duke e reflektuar atë në analizën financiare të përgjithshme.

**8. Shpenzime për djalin e saj**, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën *Vetting*, të cilat janë verifikuar nga Komisioni dhe, më tej, janë përfshirë në analizën financiare.

**9. Studime të vazhduara të vajzës së subjektit të rivlerësimit S. A.**, për të cilat, gjatë hetimit administrativ, është konstatuar se janë financiar kryesisht me bursë studimi:

a) Bursë studimi të përfituar nga vajza S. A. nëpërmjet programit Erasmus Mundus, financiar nga Komisioni European për periudhën 13.9.2013 - 11.7.2014 në Universitetin \*\*\*, Belgjikë. Bursa përfshinte: mbulimin e kostos së programit *master*; shpenzime të udhëtimit vajtje-ardhje për Shqipëri-Belgjikë; shpenzime të vizës; si dhe siguracionin shëndetësor dhe shumën 1.000 euro/muaj përgjatë vitit akademik për mbulimin e shpenzimeve të jetesës. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-të e viteve 2013 dhe 2014 përfitimin e bursës nga vajza S. A. dhe mbulimin e shpenzimeve nga Komisioni European. Subjekti deklaron se gjatë kësaj periudhe nuk ka kryer asnjë shpenzim në lidhje me shkollimin dhe jetesën e vajzës.

b) Bursë studimi të përfituar nga vajza S. A. nëpërmjet Institutit Suedez të financuar nga qeveria suedeze për të ndjekur programin *master* “Studime të Politikave Globale” pranë Universitetit të \*\*\*, Suedi për periudhën kohore 15.8.2014 - 15.6.2015.

Bursa përfshin: pagesën e shkollimit në vlerën 80.000 (tetëdhjetë mijë) SEK (ekuivalent në monedhën euro në shumën 7.902 euro); shpenzime udhëtimi në vlerën 5.000 (pesë mijë) SEK (ekuivalent në monedhën euro në shumën afërsisht 500 euro); shpenzime jetese 9.000 (nëntë mijë) SEK/muaj, si dhe siguracionin shëndetësor.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015 përfitimin e bursës nga vajza S. A., si dhe mbulimin e shpenzimeve nga Instituti Suedez. Subjekti deklaroi se gjatë kësaj periudhe nuk ka kryer asnjë shpenzim në lidhje me shkollimin dhe jetesën e vajzës.

c) Praktikë e vajzës së subjektit të rivlerësimit në Sekretariatit e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës në Strasburg nga Caisse d’Allocation Familiales për periudhën kohore shtator - dhjetor 2015.

Subjekti i rivlerësimit deklaroi në DPV-në e vitit 2015, kryerjen e praktikës së punës së vajzës S. A. në Strasburg, pa pagesë, si dhe përfitimin e ndihmës sociale për banim në masën 744.88 (shtatëqind e dyzet e katër mijë e tetëdhjetë e tetë) euro në favor të vajzës.

9.1 Komisioni ka kryer verifikimet përkatëse mbi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe ka llogaritur në mënyrë hipotetike shpenzimet mbështetur në kostot e jetesës dhe vlerat e përfituara nga bursat përkatëse. Në përfundim, Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me këto deklarime të subjektit.

**10. Kredi konsumatore në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë**, në “ProCredit Bank”, në datën 15.10.2004, për restaurim të apartamentit të prindërve, shlyer më 22.10.2006

10.1 Vlera e kredisë është marrë në konsideratë dhe është llogaritur në analizë financiare. Pas verifikimeve ka rezultuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin përkatës.

**11. Kredi në shumën 630.000 (gjashtëqind e tridhjetë mijë) lekë**, në bankën greke (aktualisht NBG), në datën 18.11.2004, për mbulim shpenzimesh familjare, e shlyer më datë 18.11.2009

11.1 Vlera e kredisë është marrë në konsideratë dhe është llogaritur në analizë financiare. Pas verifikimeve ka rezultuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin përkatës.

**12. Kredi në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë** së bashku me bashkëshortin si dorëzanës, në “Credins Bank”, datë 14.1.2016, për të ndihmuar vajzën që në janar të vitit 2016 filloi praktikën e punës në Departamentin e Operacioneve Paqeruajtëse. Nga kjo kontratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka për të shlyer këstin e fundit.

12.1 Vlera e kredisë është marrë në konsideratë dhe është llogaritur si shpenzim në analizë financiare në vitin përkatës sipas dokumentacionit të përcjellë nga subjekti. Pas verifikimeve ka rezultuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin përkatës.

**13. Kredi në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë**, në “Credins Bank”, datë 14.1.2016, për të ndihmuar vajzën që në janar të vitit 2016 filloi praktikën e punës në Departamentin e Operacioneve Paqeruajtëse, referuar deklarimit nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2016 lidhur me shpenzimet për studimet e vajzës në SHBA.

13.1 Në vijim, në pyetësorin standard<sup>6</sup> subjekti i rivlerësimit deklaroi përsëri se në janar të vitit 2016 i ka dhënë vajzës shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, pasi po këtë muaj vajza S. A. do të fillonte praktikën e punës me burim nga kredia konsumatore me afat 1-vjeçar në “Credins Bank”.

<sup>6</sup>Përgjigja nr. 9 e pyetësorit standard të datës 13.2.2020.



13.2 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur pyetësorit: kopje të letrës së Kombeve të Bashkuara datë 19.11.2015; kopje të marrëveshjes mbi pranimin e kriterëve për kryerjen e praktikës datë 19.11.2015; kopje të çqeve të pagesave nga puna në emër të vajzës S. A. ; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2016, të “Credins Bank”; Kontratë Kredie nr. \*\*\* rep., datë 14.1.2016.

13.3 Subjekti i rivlerësimit është pyetur nga Komisioni lidhur me shpenzimet e jetesës dhe shpenzimet për vendbanimin e vajzës në New York. Në përgjigje të pyetësorit të datës 12.7.2021, subjekti i rivlerësimit është shprehur se shpenzimet e vajzës kanë qenë vetëm për ushqim dhe gjatë praktikës së punës dhe më pas ka qëndruar në banesën e shtetasës R. Q..

13.4 Subjekti është shprehur se: *“Vajza S. A. pasi mbaroi praktikën, ka vendosur të emigrojë në Shtetet e Bashkuara. Gjatë kohës së praktikës ajo ka jetuar në banesën e Dr. R. Q., të ndodhur në New York, ku dhe vazhdon të jetojë edhe aktualisht. Pra, vajza nuk ka paguar shpenzime për banesën duke qenë se jeton me Dr. Q..*

*Për sa i përket shpenzimeve të jetesës (ushqim kryesisht) gjatë periudhës që vajza ka emigruar në SHBA nga muaji korrik deri në fund të vitit 2016 ka punuar në punë të ndryshme për të mbuluar shpenzimet e përditshme. Ajo ka punuar në dy restorante part-time ‘\*\*\*’ dhe ‘\*\*\*’, të ndodhura në Manhattan New York, në pronësi të shoqërisë \*\*\*, për këtë kemi vënë në dispozicion disa çeqe bankare që i përkasin kësaj periudhe. Vajza ka mundur të gjejë vetëm një pjesë të çqeve pasi kanë kaluar rreth 5 vjet nga ajo periudhë, vajza është interesuar pranë restoranteve për të marrë disa vërtetime të mëtejshme, por biznesi rezultoi i mbyllur në mënyrë permanente pas pandemisë Covid-19. Për këtë, në dispozicion dy fotografi ‘screenshot’ nga google, ku shihet se restorantet janë të mbyllura në mënyrë permanente. Gjithashtu, përveç pagesës çek nga restoranti, vajza ka marrë dhe të ardhura në formë cash, duke qenë se sipas informacioneve që më ka dhënë vajza, në SHBA është e zakonshme që punonjësit e restoranteve të marrin pjesën dërrmuese të të ardhurave nëpërmjet bakshisheve. Gjithashtu, vajza, gjatë kësaj kohe ka punuar edhe dy ditë në javë në një dyqan këpucësh të quajtur \*\*\*; të ndodhur në New York në pronësi të z. A. B. Gjithashtu edhe aty është paguar cash”.*

13.5 Nga mandatat çeqe rezultoi se shtetasja S. A. , gjatë vitit 2016, ka përfituar të ardhura të dokumentuara nga puna rreth 1.200 (një mijë e dyqind) USD në total për periudhën korrik 2016 - dhjetor 2016, pra pas periudhës që ka mbyllur *internshipin* në SHBA.

13.6 Nga sistemi *TIMS* figuron se shtetasja S. A. ka dalë nga Shqipëria në datën 3.1.2016 dhe nuk rezultoi të ketë hyrë në Shqipëri pas kësaj date. Ajo është pajisur me vizë amerikane B1/B2 dhe sipas vulave përkatëse nga shteti amerikan ka hyrë në SHBA në datën 15.1.2016 me afat deri më 14.6.2016 për arsye *internship-i*. Kjo vizë ofrohet për të gjithë shtetasit që aplikojnë me kontratë pune të përkohshme dhe gjatë kësaj kohe apo vazhdimin nuk janë të pajisur me kartë sigurimi për të punuar apo për të siguruar të ardhura të ligjshme në SHBA.

13.7 Subjekti i rivlerësimit ka informuar në përgjigje të pyetësorit datë 12.7.2021 se vajza nuk ka pasur siguracion pune dhe që për pjesën më të madhe të të ardhurave të siguruar *cash* nuk ka dokumentacion provues.

13.8 Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se shtetasja R. Q. është shtetase e huaj, që punon në Universitetin në \*\*\* në Baltimore. Nuk ka ndonjë dokumentacion provues lidhur me qëndrimin e vajzës së subjektit në këtë apartament, si dhe mospagimin nga ana e saj të qirasë përkatëse (qëndrimin falas). Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar këtë marrëdhënie në ndonjë deklaram periodik vjetor apo të paraqesë dokumentacion provues mbi ekzistencën e kësaj marrëdhënieje.

13.9 Në DPV-në e vitit 2017 subjekti i rivlerësimit deklaroi se vajza është e punësuar prej muajit shtator si asistent/ligjore pranë një zyrë ligjore me pagesë 600 (gjashtëqind) USD/javë. Mbështetur në këtë deklaram duket vijueshmëria dhe se vajza e subjektit të rivlerësimit figuron me të ardhura të pavarura nga familja prej shtatorit të vitit 2017.

13.10 Nga kërkimet e kryera në internet rreth kostove minimale të jetesës në qytetin e New Yorkut, duke konsideruar statistikat për varfërinë në SHBA sipas “census.gov” (duke mos marrë në konsideratë faktin që vajza jeton në një nga zonat më të shtrenjta të qytetit të New York-ut (New York County/Manhattan)) rezulton se kostot minimale për shpenzime jetese (pa përfshirë shpenzime qiraje) janë rreth 1.041 USD/muaj<sup>7</sup> dhe shpenzimet minimale të qirasë janë rreth 1.629<sup>8</sup> USD/muaj.

13.11 Në tabelën vijuese janë llogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e vajzës në qytetin e New Yorkut për vitin 2016, duke marrë në konsideratë:

a) shpenzime minimale qiraje në vlerën 2.507.813 (dy milionë e pesëqind e shtatë mijë e tetëqind e trembëdhjetë) lekë në vit (ose 208, 984 lekë në muaj, ekuivalent në dollarë në shumën 1.629 USD) dhe shpenzime jetese; ose

b) duke llogaritur vetëm shpenzime jetese.

Viti 2016	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Të ardhura nga internship	0	0
Të ardhura nga puna si shitëse/hostess (me rezervë)	153.948	153.948
Të ardhura monetare/ të dërguara nga subjekti i rivlerësimit	500.000	500.000
		1.601.829
Shpenzime konsumi/ jetesa (minimum jetik)	1.601.829	
Shpenzime qiraje	2.507.813	0
Rezultati	-3.455.694	-947.881

### 13.12 Në përfundim rezulton se:

a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* shpenzimet për jetesën e vajzës në New York, si dhe mënyrën e përballimit të tyre. Deklarimet e saj gjatë hetimit nuk përputhen me DPV-të apo me ndonjë dokumentacion ligjor provues.

b) Duket se subjekti rivlerësimit nuk ka deklaruar lidhur me këto financime duke i fshehur ato.

c) Subjekti rezulton në pamundësi financiare në vlerën -3.234.501 (tre milionë e dyqind e tridhjetë e katër mijë e pesëqind e një) lekë për të përballuar shpenzimet e minimumit jetik së bashku me shpenzimet e qirasë për vajzën e saj gjatë qëndrimit në New York, të llogaritura nga Komisioni deri në këtë moment.

ç) Subjekti duhet të provojë me dokumentacion ligjor provues mundësitë financiare për përballimin e shpenzimeve të jetesës për vajzën dhe burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave.

13.13 Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të shpjeguar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

13.14 Subjekti i rivlerësimit, në vlerësim të barrës së provës, ka shpjeguar: “Znj. Q. ka në pronësi një banesë në \*\*\* (apt \*\*\*), New York. Duke qenë se ajo gjatë javës punon në Baltimore, Maryland dhe kthehet vetëm fundjavave në banesën në New York dhe jeton vetëm, i ka ofruar vajzës të qëndrojë në banesën e saj duke qenë se ka hapësirë të konsiderueshme në banesë. Gjatë kësaj periudhe vajza nuk ka paguar qira, thjesht ka kontribuar në mirëmbajtjen e apartamentit”.

13.15 Subjekti ka bashkëlidhur si dokument deklaratën e nënshkruar nga znj. R. Q., e cila deklaron se shtetasja S. A. ka qëndruar që prej vitit 2016 si e ftuara e saj në një dhomë në apartamentin e saj, si dhe ka vënë në dispozicion të dhënat e kësaj shtetaseje nëse Komisioni do të vlerësonte ta pyeste.

13.16 Lidhur me shpenzimet e jetesës, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar për Komisionin se ashtu siç edhe ka deklaruar, nuk ka paguar shpenzime për jetesën e vajzës, veç shumës prej

<sup>7</sup><https://www.census.gov/topics/income-poverty/poverty/guidance/poverty-footnotes/cps-historic-footnotes.html>. Të dhënat janë marrë duke konsideruar shpenzimet për një person në vitin 2016, në total 12.486 USD.

<sup>8</sup><https://www.epi.org/resources/budget/budget-factsheets/#/1886>; The Economic Policy Institute’s Family Budget Calculator: Technical Documentation | Economic Policy Institute (epi.org). Të dhënat për qiranë janë mesatarizuar duke marrë në konsideratë statistikat për një person për vitin 2013 dhe vitin 2017 për qytetin e New Yorkut, nga e cila rezulton shuma prej 19.548 USD në vit si shpenzime qiraje.

500.000 (pesëqind mijë) lekë dhe se vajza ka siguruar vetë jetesën nëpërmjet punësimit, i cili në disa raste ka qenë i padokumentuar (në të zezë) për shkak të dokumenteve.

13.17 Trupi gjykues ka dëgjuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore dhe ka vlerësuar shpjegimet dhe provat e paraqitura në vijim të barrës së provës lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve ndaj subjektit të rivlerësimit mbi qëndrimin e vajzës në SHBA në vitin 2016. Nga verifikimi ka rezultuar se adresa e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si banesë/vendqëndrim për vajzën gjendet afër vendit të deklaruar të punës së vajzës së subjektit. Kjo adresë përputhet me adresën e deklaruar nga vajza e subjektit të rivlerësimit në DPV-të e viteve 2016 dhe 2017, por nuk rezulton e deklaruar në deklaratën *Vetting* as si adresë dhe as si marrëdhënie konkrete në asnjë rubrikë (përfshi edhe atë konfidenciale). Në deklaratën e paraqitur nga znj. R. Q. nuk pasqyrohen detaje lidhur me pagesën apo përmbushje të ndonjë detyrimi nga ana e vajzës së subjektit, për të provuar mbulimin e shpenzimeve gjatë qëndrimit si për qiranë ashtu edhe për konsumin mujor, duke heshtur lidhur me këto shpenzime. Nëpërmjet provave të paraqitura, subjekti ka arritur të provojë vetëm vendqëndrimin e vajzës në këtë adresë, por asgjë tjetër lidhur me pagimin e shpenzimeve apo mbulimin e tyre. Në vlerësim të trupit gjykues, ky dokument është i pamjaftueshëm për të provuar se vajza ka pasur 0 (zero) shpenzime gjatë vendqëndrimit në SHBA dhe, për këtë arsye, ato shpenzime duhet të llogariten në ngarkim të subjektit të rivlerësimit pasi rezulton e pamundur që të jenë përballuar nga vetë vajza e subjektit.

13.18 Lidhur me mbulimin e kostove të jetesës nga vetë vajza e subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka vlerësuar shpjegimet e subjektit, e cila ka pretenduar se ato shpenzime janë përballuar nga vajza nëpërmjet punës së saj, që për shkak të statusit shpesh herë ka qenë e detyruar të punojë në të zezë, duke qenë kështu në pamundësi për të provuar të gjitha të ardhurat e përfituara. Duke marrë në konsideratë se për kostot minimale të llogaritura për jetesën përfshihet vlera prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh të paguar nga subjekti i rivlerësimit, vlerën prej 153.948 (njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) lekë të dokumentuar të përfituar nga punësimi, trupi gjykues krijon bindjen se ajo mund të këtë përballuar vetë shpenzimet e tjera. Ky konkluzion vjen mbështetur vetëm në bindjen e brendshme, pasi subjekti i rivlerësimit dhe vajza nuk kanë deklaruar asgjë në Deklaratën *Vetting* lidhur me kosto të mundshme jetese apo mënyrën e mbulimit të tyre dhe as në vijim të rezultateve të hetimit nuk kanë sjellë ndonjë dokumentacion provues. E vetmja mënyrë që ka Komisioni për të provuar vërtetësinë e deklarimeve është nëpërmjet deklarimeve periodike apo Deklaratës *Vetting* dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, të cilat në vlerësim të trupit gjykues mbeten vetëm në nivel deklarativ të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit.

13.19 Në vijim, referuar arsyetimit më sipër, mbështetur në një analizë financiare hipotetike dhe me shpenzime minimaliste (pasi mund të ketë edhe shumë veprime/shpenzime të tjera të panjohura), si dhe duke pranuar se vajza e subjektit ka përballuar vetë shpenzime për jetesën (ushqimin), rezultati i analizës financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur me të u rishikua dhe pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit për vitin 2016 u reduktua në vlerën - 2.507.813 (dy milionë e pesëqind e shtatë mijë e tetëqind e trembëdhjetë) lekë.

13.20 Për sa më lart, trupi gjykues vlerëson gjithashtu se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me kërkesat e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi në Deklaratën *Vetting* nuk ka deklaruar as ajo dhe as vajza mënyrën e mbulimit të shpenzimeve në SHBA dhe as përfitime të pretenduara përgjatë gjithë procesit të rivlerësimit të zhvilluar në Komision.

13.21 Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të paplotë dhe të pasaktë të pasurive të saj në kuptim të pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, duke u përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë ato.

## GJETJE TË TJERA

**14. Depozitë në emrin e vajzës S. A. ,** të cilën subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2013, për aplikim për leje qëndrimi në Norvegji për mbulimin e shpenzimeve të jetesës gjatë periudhës së shkollimit. Shuma e depozituar në gusht të vitit 2013 është 12.500 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind) euro.

14.1 Vajza e subjektit të rivlerësimit, S. A. , pas përfundimit të arsimit të lartë pranë Fakultetit Juridik, në periudhën 2008 – 2013 (sistemi 3+2), ka aplikuar dhe ka fituar të drejtën e studimit për programin *master* në universitetin e Oslos në Norvegji. Sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit, me qëllim aplikimin për pajisje me leje qëndrimi në Norvegji, nevojitej si garanci shuma prej 12.500 (dymbëdhjetë mijë) euro, që do të përdorej nga shtetasja S. A. për mbulimin e shpenzimeve të jetesës gjatë periudhës së shkollimit.

14.2 Sipas veprimeve bankare në “Raiffeisen Bank” të kryera në llogarinë rrjedhëse në euro të shtetasës S. A. rezulton se në datën 30.4.2013 është transferuar shuma 12.537 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) euro për llogari të universitetit “\*\*\*\*”, në Oslo.

14.3 Në datën 17.7.2013 universiteti “\*\*\*\*” në Oslo ka kthyer pas vlerën 11.866,24 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë e njëzet e katër qindarka) euro dhe në datën 29.8.2013 shtetasja S. A. e ka kaluar këtë vlerë në llogarinë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit.

14.4 Në përfundim rezulton se:

a) Nga analiza financiare në vitin 2013 subjekti rezulton me burime të ligjshme nga pagat për krijimin e kësaj shume.

b) Lidhur me depozitën në vlerën 520.000 (pesëqind e njëzet mijë) lekë nga hetimi është konstatuar se burimi i krijimit është nga të ardhura të ligjshme.

c) Lidhur me gjendjen cash 800.000 (tetëqind mijë) lekë në emër të bashkëshortit, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2004 çeljen e depozitës që ka shërbyer si burim krijimi.

ç) Lidhur me vlerën e huazuar prej 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro, nga verifikimi i kryer ka rezultuar se nuk provohet burimi i të ardhurave të huadhënësit A. B., si dhe subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues për mënyrën e likuidimit të kësaj vlere me tre këste brenda vitit 2013.

d) Lidhur me shumën 85.000 (tetëdhjetë e pesë mijë) lekë kursime familjare nga qiratë e shtëpisë rezulton se nuk do të konsiderohen deri në këtë moment si burim për krijimin e shumës prej 12.500 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind) euro, pasi nuk i janë nënshtruar tatimit në burim.

14.5 Komisioni ka kërkuar nga subjekti shpjegime lidhur me mospërputhjet e rezultuara nga hetimi administrativ.

14.6 Për depozitën e çelur në vitin 2004 që ka shërbyer si burim krijimi për shumën *cash* 800.000 (tetëqind mijë) lekë, subjekti ka kërkuar që të llogariten të ardhurat në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë të përfituara nga bashkëshorti në vitin 2008 dhe të deklaruar në DPV-të përkatëse me prejardhje nga shitja e shtëpisë në pronësi të gjyshit të bashkëshortit në Kavallas, Greqi. Për këtë qëllim, subjekti ka vënë në dispozicion kontratën e shitblerjes në të cilën parashikohet mbajtja në burim dhe pagesa e tatimit në shitje.

14.7 Për burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit A. B., subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Tiranë mbi pagesën e taksave vendore të vitit 2021 nga subjekti fizik shtetasi A. B..

14.8 Në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, Komisioni gjykon se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka mungesë burimesh të ligjshme të të ardhurave në vitin 2008 për krijimin e kësaj shume. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit

disponon vetëm një depozitë bankare të krijuar në vitin 2004, e cila në fund të vitit 2008 rezultonte në vlerën 543.213 (pesëqind e dyzet e tre mijë e dyqind e trembëdhjetë) lekë dhe nuk disponon llogari rrjedhëse tjetër në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë siç deklaroi subjekti. Pra, kjo situatë e vendos subjektin në kushtet e gurmës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

14.9 Lidhur me dokumentacion për shumën e huazuar në vlerën 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro, Komisioni gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit, shtetasit A. B. për huazimin e kësaj shume. Njëkohësisht, subjekti nuk disponon dokumentacion për të vërtetuar likuidimin e kësaj huaje me tre këste brenda vitit 2013, siç ka deklaruar në DPV-të përkatëse. Në përfundim të hetimit administrativ, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me bilanc pozitiv në periudhën 2003 – 2015 dhe për sa i përket problematikës së shumës së huazuar, subjekti është në kushtet e gurmës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**15. Tërheqja e shumës 900.000 (nëntëqind mijë) lekë nga bashkëshorti**, të cilën subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2012, të përdorura pjesërisht për arsye shëndetësore dhe pjesën tjetër *cash* në banesë për raste emergjence.

15.1 Subjekti i rivlerësimit, në DPV-në e vitit 2012, ka deklaruar vetëm tërheqjen e vlerës 900.000 (nëntëqind mijë) lekë, pa specifikuar se sa është vlera e shpenzimeve shëndetësore dhe sa është vlera e të ardhurave *cash* të disponuara në banesë për emergjencë shëndetësore.

15.2 Lidhur me burimin e kësaj vlere, subjekti i rivlerësimit deklaroi në DPV-në e vitit 2012 se kjo vlerë është mbledhur nga bashkëshorti që prej vitit 2003.

15.3 Nga veprimet bankare rezultoi se në shtator të vitit 2004 shtetasi A. A. ka depozituar në llogari rrjedhëse shumën 428.000 (katërqind e njëzet e tetë mijë) lekë në “Raiffeisen Bank”. Kjo shumë, së bashku me shtesën prej 25.117 (njëzet mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë (totali prej 453.630 lekësh) është çelur depozitë në datën 21.6.2005. Kjo depozitë është rinovuar çdo vit duke u kapitalizuar interesat dhe është shtuar herë pas here nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deri sa ka arritur në vlerën 1.035.479 (një milion e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë në tetor të vitit 2012, e cila është tërhequr në vlerën 900.000 (nëntëqind mijë) lekë në nëntor të vitit 2012 dhe vlera prej 135.000 (njëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekësh është mbyllur në depozitë, por subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2004 çeljen e kësaj llogarie bankare nga bashkëshorti, që ka shërbyer si burim.

15.4 Lidhur me vlerën e paguar për trajtimin shëndetësor të shtetasit A. A., subjekti i rivlerësimit ka përcjellë<sup>9</sup> në përgjigjet e pyetësorit të datës 2.6.2021, dokumentacionin për shpenzimet e kryera në vlerën 110.000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë, e cila është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të vitit 2012.

15.5 Në përfundim konstatohet se:

*a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2004 çeljen e depozitës në emër të bashkëshortit, e cila ka shërbyer si burim për krijimin e shumës prej 900.000 (tetëqind mijë) lekësh.*

*b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2012 vlerën e saktë të të ardhurave cash të disponuara në banesë.*

15.6 Komisioni ka kërkuar nga subjekti shpjegime lidhur me këtë mospërputhje.

15.7 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shpjegime për këtë mospërputhje të rezultuar nga hetimi administrativ.

15.8 Në vlerësim të trupit gjykues subjekti dhe bashkëshorti kanë rezultuar me bilanc pozitiv për periudhën 2003 – 2015 dhe mosdeklarimi i depozitës që ka shërbyer si burim për krijimin

<sup>9</sup>Përgjigja nr. 5 e pyetësorit të datës 2.6.2021/vërtetim nr. 2503, \*\*\* Clinic/Epikrizë nga QSUT-ja.

e kësaj shume e vendos subjektit në kushtet e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**16. Derdhje cash në shumën 13.000 (trembëdhjetë mijë) euro në emër të vajzës S. A.** – nga hetimi i lëvizjeve bankare rezulton se shtetasja S. A. ka derdhur cash shumën 13.000 (trembëdhjetë mijë) euro, në datën 16.11.2012, në llogarinë e saj në “Credins Bank”. Kjo shumë është tërhequr cash në datën 27.11.2012, përkatësisht në vlerat 7.000 (shtatë mijë) euro dhe 6.000 (gjashtë mijë) euro.

16.1 DPP-ja, me shkresën e dërguar në Komision në datën 5.2.2020, provon tërheqjen e këtyre dy shumave në datën 27.11.2012, nga “Credins Bank”.

16.2 Komisioni ka kërkuar nga subjekti i rivlerësimit shpjegime për burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume.

16.3 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shpjegime në prapësime.

16.4 Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**17. Shkollimi i vajzës** – subjekti i rivlerësimit deklaron në pyetësonin standard se vajza S. A. ka përfutuar në datën 15.8.2018 një bursë studentore për ndjekjen e studimeve *master* në \*\*\* School of Law, në vlerën 35.500 (tridhjetë e pesë mijë e pesëqind) USD.

17.1 Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit rezulton se vajza S. A. është trajtuar në datën 31.8.2018 me kredi studentore në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) USD dhe figuron e punësuar si asistente ligjore pranë një zyre emigracioni në New York.

## **18. Analiza financiare**

### **18.1 Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016**

**18.1.1** Për analizimin e likuiditeteve janë marrë në konsiderate: (a) gjendja *cash* në banesë, e deklaruar në DPV-të nga subjekti i rivlerësimit; (b) gjendja e likuiditeteve në bankë të subjektit të rivlerësimit, të bashkëshortit dhe vajzës në fillim dhe në fund të vitit, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

18.1.2 Në përfundim, pasi janë vlerësuar të gjitha provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti rivlerësimit në prapsimet e saj si dhe në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës 2003 – 2015, rezulton me burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e saj në raport me të ardhurat e ligjshme të konsideruara nga Komisioni, por ajo rezulton me balancë negative në vitin 2016, e reflektuar nga situata e rezultuar lidhur me shpenzimet për vajzën në SHBA, në shumën - 2.132.672 (minus dy milionë e njëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

### **18.2 Analiza financiare para vitit 2003**

18.2.1 Nga analiza financiare kumulative e kryer nga njësia e shërbimit ligjor, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën -2.977.766 (minus dy milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqinde gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e saj në raport me të ardhurat e ligjshme të konsideruara nga Komisioni. Ky rezultat ka ardhur pas rishikimit të analizës financiare nga Komisioni, i cili mori në konsideratë disa të ardhura të dokumentuara nga subjekti i rivlerësimit e të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit.

18.2.2 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të paplotë e të pasaktë të pasurive të saj në kuptim të pikave 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe se ajo rezulton me pamjaftueshmëri financiare për të mbuluar shpenzimet dhe për të justifikuar pasuritë në kuptim të germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë**

14. Trupi gjykues çmon se për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të paplotë dhe të pasaktë të pasurive të saj në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, duke u përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë shpenzimet për vajzën (personi i lidhur) në vitin 2016 në SHBA dhe mënyrën e përballimit të tyre, dhe për shkak se rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në përputhje me pikat 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në kuptim të germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

15. Trupi gjykues vlerëson se veprimet e kryera nga kjo gjyqtare për të përfituar një pasuri në statusin “e pastrehë” (prej saj dhe personit të lidhur), pasuri të cilën e ka përdorur më tej duke gjeneruar të ardhura, nuk duket e papranueshme duke e klasifikuar këtë sjellje sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, në cenim të besimit të publikut të drejtësia.

16. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së saj në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe ndaj saj duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

## **B. KONTROLI I FIGURËS**

17. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramive dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 dhe, në përfundim, ka dërguar në datën 30.10.2017 raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin Kaçe Agolli, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës, raport të cilin e ka deklasifikuar plotësisht.

18. Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2021, i ka kërkuar DSIK-së përditësim të informacionit lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli, përderisa raporti pararendës kishte kryer verifikimet deri në datën 30.10.2017 dhe deklasifikim. DSIK-ja ka deklasifikuar raportin duke mos sjellë të dhëna shtesë për këtë subjekt rivlerësimi.

19. Komisioni i kërkoi informacion Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin e rivlerësimit, e cila (sektori i protokollit dhe arkivit) me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2020, sqaron se nga kontrolli i ushtruar në Regjistrat e Kallëzimeve dhe Procedimeve Penale të Prokurorisë së Përgjithshme nuk rezultoi të ketë çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit.

20. Komisioni i kërkoi informacion Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila informon se shtetasja Kaçe Agolli përmendet si e kallëzuar në kuadrin e një procedimi penal të vitit 2020, i cili është në fazën e hetimit. Procedimi penal nr. \*\*\* lidhet me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.3.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është trajtuar më poshtë në kuadrin e vlerësimit profesional.

21. Ky institucion ka informuar se nuk ka emër të regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale pranë kësaj prokurorie dhe pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në emër të shtetasës Kaçe Agolli.

## **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës**

22. Trupi gjykues vlerëson se nga rrethanat e konstatuara nga Grupi i Punës së DSIK-së dhe nga Komisioni për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, nuk rezultoi se subjekti Kaçe Agolli ka bërë deklaramit të pamjaftueshëm sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se nuk u provua gjatë hetimit që subjekti i rivlerësimit të

jetë në kushtet e pikave 2 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

23. Ky raport profesional është përgatitur bazuar në raportin e sjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimet e paraqitura pranë Komisionit, si dhe gjetjet e evidentuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

24. Në analizë të përbashkët të dosjeve të vlerësuara nga KLGJ-ja ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli ka njohuri të mjaftueshme në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit dhe konkretisht lidhur me shqyrtimin e mosmarrëveshjeve në të drejtën familjare që kanë për objekt birësimin e fëmijëve të mitur nga shtetas të huaj (shihni dokumentin nr.1), mosmarrëveshjet bashkëshortore në zgjidhjen e martesës (shihni dokumentin nr. 2 dhe dosjet nr.1, nr. 2, nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5) dhe kundërshtimin e atësisë së fëmijëve të lindur gjatë martesës (shihni dokumentin nr. 3).

Në tri dokumentet ligjore të prezantuara nga subjekti i rivlerësimit dhe në pesë dosjet e përzgjedhura me short, subjekti i rivlerësimit tregon aftësi në arsyetimin e vendimeve ligjore të vëzhguara dhe respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga dokumentet ligjore dhe dosjet e vëzhguara që të jetë cenuar nga gjykatat më të larta në aspektin e arsyetimit ligjor të vendimeve gjyqësore. Konstatohet se në vendimet përfundimtare subjekti i rivlerësimit pasqyron edhe vendimet e ndërmjetme të gjykatës për ekspertimin e çështjes (shihni dokumentin nr. 2 dhe dosjet nr.1, nr. 2, nr. 4 dhe nr. 5), për gjykimin në mungesë (shihni dokumentin nr. 3 dhe dosjet nr.1, nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5), për marrjen e provave, për rinjoftimin e palëve, si dhe për zëvendësimin e ekspertit (shihni dosjet nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5).

Nga tri dokumentet ligjore të prezantuara nga subjekti i rivlerësimit vetëm për një rast është ushtruar e drejta e ankimit dhe është lënë në fuqi vendimi nga Gjykata e Apelit Tiranë (shihni dokumentin nr. 3), por nuk ka të dhëna nëse është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Për pesë dosjet e përzgjedhura me short nuk ka pasur ankimim për asnjërën prej tyre.

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se në 4 raste është tejkaluar afati 4-mujor i gjykimit (shihni dosjet nr.1, nr. 2, nr. 4 dhe nr. 5), por konstatohet se koha e gjykimit nuk ka cenuar standardin e procesit të rregullt gjyqësor.

Në tri dokumentet ligjore të prezantuara nga subjekti nuk ka të dhëna për datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë dhe, për rrjedhojë, nuk mund të llogaritet koha e gjykimit (shihni dokumentin nr.1, nr. 2 dhe nr. 3).

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohë të vendimeve gjyqësore. Në 1 rast vendimi është arsyetuar për 18 ditë (shihni dosjen nr. 1), për 14 ditë (shihni dosjen nr. 2), për 8 ditë (shihni dosjen nr. 3), për 7 ditë (shihni dosjen nr. 4) dhe për 23 ditë (shihni dosjen nr. 5). Ndërkohë që në 3 raste konstatohet se vendimet janë dorëzuar tej afatit ligjor 10-ditor (shihni dosjet nr.1, nr. 2 dhe nr. 5). Rrjedhimisht është cenuar parimi i një procedimi të rregullt ligjor.

Subjekti i rivlerësimit si praktikë të saj pune, pas marrjes së çështjes, nuk ka proceduar me vendim formal, por me shënim drejtuar sekretares për caktimin e seancës përgatitore të pajtimit dhe njoftimin e palëve brenda afatit 10-ditor. Nga pesë dosjet e vëzhguara vihet re se në 2 raste çështja është mbajtur 12 dhe 24 ditë pa veprime për kalimin në seancë gjyqësore (shihni dosjet nr. 4 dhe nr. 5).

Subjekti i rivlerësimit respekton afatet ligjore në caktimin e seancave, por nuk citon shkakun ligjor që shtyn seancën gjyqësore. Vihet re se në total janë 27 seanca joproduktive, të cilat kanë dështuar për mosparaqitje të palëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe në 4 raste vihet re gjithashtu mungesa e gjyqtarës për shkaqe shëndetësore (shihni dosjet nr. 2, nr. 4 dhe nr. 5).



Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short janë konstatuar edhe mangësi të subjektivitetit të rivlerësimit në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në to. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale, por në 5 raste mungon fleta e shortit dhe vendimi formal për kalimin e çështjes për vendime përgatitore. Në 1 rast mungon kërkesëpadia (shihni dosjen nr. 3) dhe në 1 rast mungon procesverbali i seancës së parë të veprimeve përgatitore (shihni dosjen nr. 5).

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se subjekti i rivlerësimit komunikon me etikë me pjesëmarrësit në proces dhe jashtë tij, gjuha e përdorur në akte është normale dhe komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore.

25. Subjekti i rivlerësimit për periudhën 3-vjeçare të rivlerësimit ka qenë pjesëmarrëse në 5 seminare trajnimi, me 9 ditë trajnim në 3 vjet. Për rrjedhim, subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar standardin minimal të pjesëmarrjes në formimin vazhdues prej 28 ditësh në 3 vjet, sipas pikës 5, të nenit 76, të ligjit për statusin.

26. Gjatë periudhës së rivlerësimit për gjyqtaren Kaçe Agolli janë paraqitur në Inspektoratin e KLD-së 8 ankesa, nga të cilat 4 ankesa për zvarritje gjykimi, 3 ankesa për mosrespektim formal ligji dhe 1 ankesë për ligjshmëri vendimi. Pas verifikimit të 4 ankesave për zvarritje gjykimi është vendosur arkivimi për 1 ankesë si e përsëritur, për 2 ankesa shkelja do t'i evidentohet për efekt vlerësimi etik e profesional, ndërsa për 1 ankesë është konkluduar tërheqje vëmendje me shkrim gjyqtare. Pas verifikimit të 3 ankesave për subjektin e rivlerësimit për mosrespektim formal ligji është vendosur se për 2 ankesa (njëra prej të cilave informacion periodik nga gjykata, trajtuar më poshtë) shkelja do të regjistrohet për efekt vlerësimi etik dhe profesional gjyqësor, ndërsa 1 ankesë ka rezultuar pa shkelje për gjyqtaren.

27. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Kaçe Agolli, përgjatë periudhës së rivlerësimit është regjistruar kërkesa për procedim disiplinor nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2014, e Ministrisë së Drejtësisë përcjellë KLD-së për caktimin e masës disiplinore “Dërgim për 1-2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtarja ka emërimin e saj”. Kërkesa është shqyrtuar në mbledhje të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë të datës 28.5.2014 dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.5.2014, është marrë masa disiplinore “Vërejtje” për vonesa në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

28. Lidhur me konstatimin e evidentuar nga KLGJ-ja për dorëzimin e vendimeve tej afatit ligjor, subjekti i rivlerësimit sqaron se tejkalimi i afateve ka ndodhur për shkak të ngarkesës së lartë të çështjeve gjyqësore të shqyrtuara. Subjekti ka bashkëlidhur si dokumentacion vërtetimin e lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku evidentohet numri i dosjeve të shqyrtuara nga subjekti përgjatë viteve 2014 – 2016.

Për sa i përket konstatimit në raportin e KLGJ-së mbi mungesën e fletës së shortit, subjekti i rivlerësimit shpjegon se në të gjitha rastet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranës nuk ka fletë shorti. Lidhur me mungesën e vendimeve formale për kalimin e çështjes në veprime përgatitore, subjekti argumenton se çështjet gjyqësore i përkasin viteve 2014 – 2016 dhe sipas nenit 158/a të Kodit Civil të asaj periudhe kohore gjyqtari thjesht caktonte seancën përgatitore, ndërsa vendimi merrej nëse do të rezultonte një nga kushtet e përcaktuara në nenin 158/a.

29. Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit janë të pranueshme dhe gjetjet e konstatuara në raportin e KLGJ-së nuk janë në atë nivel që të ndikojnë në vlerësimin profesional të saj nën nivelin minimal kualifikues të kërkuar nga ligji.

## **VLERËSIMI I DENONCIMEVE**

30. Në Komision janë paraqitur 11 denoncime, 7 prej tyre i drejtohen subjektivitetit të rivlerësimit si gjyqtare e vetme, të tjerët i drejtohen trupit gjykues ose një grupi gjyqtarësh.

30.1 Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime për denoncimet, të cilat në përfundim, pasi u analizuan nuk u evidentuan shkelje ligjore apo veprime të kryera prej tij, që të cenojnë figurën apo aftësitë e tij profesionale gjatë ushtrimit të detyrës.

31. Gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni është vënë në dijeni mbi disa të dhëna në formë *indicie* të marra në portalin mediatik <http://www.panorama.com.al/vendimi-gjykata-sekuestro-ndaj-biznesit-te-fazllic-ne-porto-romano-4-milione-euro-borxh/>, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka lëshuar urdhërezekutimin për sekuestrimin e biznesit të shtetasit D. F., që nëpërmjet shoqërisë së tij “\*\*\*\*” u shndërrua në kreditor për zhvillimin e tokave kënetore të Porto Palermos në park industrial.

31.1 Lidhur me këto të dhëna, Komisioni kërkoi dosjen e plotë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga verifikimi i fashikullit të dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021, nuk rezultuan *indicie* që mund të merren në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

32. Komisioni është vënë në dijeni mbi disa të dhëna në formë *indicie* konfidenciale sipas të cilave subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka marrë vendimin nr. \*\*, datë 24.3.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim ky që ka vendosur detyrimin e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. për t’i paguar shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dëmshpërblim në vlerën 25.188.500 (njëzet e pesë milionë e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) euro.

32.1 Komisioni ka vlerësuar të arsyeshme të verifikojë *indiciet* e mbledhura dhe, për këtë arsye, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kopje të vendimit gjyqësor.

32.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e trupit gjykues dhe ka shqyrtuar çështjen civile me nr. regjistri themeli \*\*\*, me palë paditëse shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., palë e paditur dega e shoqërisë “\*\*\*\*” dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Trupi gjykues, me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.3.2009, ka vendosur detyrimin e palëve të paditura shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., që t’i paguajë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. vlerën e dëmit jashtëkontraktor në shumën 25.188.500 (njëzet e pesë milionë e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) euro. Anëtari i trupit gjykues në pakicë çmon se padia e paraqitur nuk është e mbështetur në ligj dhe në prova dhe, si e tillë, duhet të rrëzohet.

32.3 Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.4.2010. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.3.2011, nuk ka pranuar rekursin e paraqitur kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

32.4 Vendimi nr. \*\*\*, datë 24.3.2009, i Gjykatës Shqiptare është trajtuar për ekzekutim nga Gjykata e Amsterdimit. Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit ka rezultuar se Gjykata e Apelit të Amsterdimit me vendimin e datës 17.7.2018 ka vendosur se vendimi i Gjykatës Shqiptare: “(ishte) në mënyrë aq evidente në kundërshtim me të drejtën shqiptare të cituar nga vetë ajo gjykatë sa që (...) doemos duhet konkluduar se bëhet fjalë për një gabim të dukshëm dhe se asnjë gjykatë që vepron në mënyrë të arsyeshme (...) nuk do të kishte ardhur deri te një gjykim i njëjtë. E njëjta vlen edhe për vendimin e Gjykatës së Apelit të Tiranës, e cila përkundër ...”.

32.5 Në vijim, Gjykata e Apelit në Amsterdam ka vlerësuar se, thënë shkurt, zhvillimi i procesit shqiptar nuk i ka plotësuar kriteret që duhet të parashtrohen në bazë të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe prandaj vendimi gjyqësor shqiptar nuk vjen në konsideratë për t’u ekzekutuar në Holandë.

32.6 Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime mbi këto konstatime, si dhe mbi qëndrimin e saj si anëtare e trupit gjykues që ka dhënë vendimin nr. \*\*\*, datë 24.3.2009.

32.7 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se paditësi është subjekti i së drejtës shqiptare, pasi ai është regjistruar si person juridik pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbajtës i titullit

konkensionar. Sipas arsytimit të subjektit, dëmi është shkaktuar në Shqipëri dhe padia ngrihet në vendin ku shkaktohet dëmi.

Në vijim, subjekti i rivlerësimit shprehet se gjithë arsytimi i vendimit është në funksion të nenit 608 të Kodit Civil, pasi ekzistojnë gjithë elementët kumulativë të kërkuar nga ligji për dëmin jashtëkontraktor.

Lidhur me konstatimin e ekspertëve holandezë, subjekti i rivlerësimit shprehet se vendimi është i gjatë, por jo i pakuptueshëm: *“Nuk arrij dot të kuptoj përse vendimi nga të tjerë juristë jo shqiptarë është cilësuar i pakuptueshëm. Kuptueshmëria s’varet prej meje, në një kohë që vendimi respekton gjithë standardet e detyrueshme nga Kodi i Procedurës Civile. Nëse vendimi ynë do të ishte i pakuptueshëm, Gjykata e Apelit duhet ta kishte prishur. Nëse vendimi ynë dhe i Gjykatës së Apelit do të ishte i pakuptueshëm dhe i pazbatueshëm, Gjykata e Lartë duhet të kishte ndërhyrë dhe t’i prishte të dy vendimet. Kjo s’ka ndodhur e mendoj se në sy të ligjit, ky i fundit është respektuar tërësisht prej nesh në këtë vendimmarrje”.*

32.8 Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe qëndrimeve të mbajtura prej saj, trupi gjykues arsyeton se vendimi nr. \*\*\*, datë 24.3.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pjesë e së cilës ka qenë edhe subjekti rivlerësimit, është lënë në fuqi nga të gjitha shkallët e gjykimit pavarësisht dyshimeve të pretenduara për ndërhyrje. Ky vendim i dhënë nga një gjykatë shqiptare është kërkuar për t’u ekzekutuar (detyrimi i njohur sipas vendimit nr. \*\*\*) nga një gjykatë e huaj, e cila e ka vlerësuar duke e gjetur atë të pazbatueshëm, pikërisht për shkak të mënyrës së si është përlllogaritur detyrimi në raport me situatën faktike dhe legjislacionin shqiptar të zbatueshëm. Nga qëndrimi i Gjykatës së Apelit të Amsterdimit konstatohet se arsytimi i përdorur dhe konkluzioni i gjykatës bien ndesh me vetë dispozitat referuese të Kodit Civil Shqiptar dhe vetë qëllimin që ky vendim synon të arrijë, garantimin dhe dëmshpërblimin e drejtë të palëve. Trupi gjykues çmon se aftësia dhe detyra e një gjyqtari është të zbatojë ligjin dhe ta interpretojë atë krahas jurisprudencës së detyrueshme, nën frymën e qëllimit të tij, jo në mënyrë të fragmentarizuar e jashtë kontekstit. Po ashtu, gjykata duhet të ishte kujdesur që të plotësoheshin kriteret në bazë të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe që vendimi të ishte i ekzekutueshëm, pasi subjekti vetë ishte në dijeni të ekzistencës së marrëdhënies së palës paditëse me shoqëritë e huaja.

32.9 Trupi gjykues, duke e vlerësuar qëndrimin e Gjykatës së Apelit të Amsterdimit si një qëndrim zyrtar, në fuqi, dhe i marrë nga një institucion i huaj, tërësisht i pavarur dhe i pandikuar nga sistemi i së drejtës shqiptare, si dhe i pandikuar lidhur me situatën aktuale konkrete rivlerësuese të subjektit të rivlerësimit, i konsideron qëndrimet e saj të besueshme dhe vlerëson se me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.3.2009, subjekti rivlerësimit ka treguar mungesë dhe dobësi në drejtim të aspektit të njohurive mbi ligjin dhe aftësive për të interpretuar jurisprudencën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, mungesë të elementëve garantist të së drejtës, e se kjo rrethanë duhet vlerësuar në kushtet nenit 61 pika 5 të ligjit nr 84/2016 duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e cenimit të besimit të publikut të sistemit të drejtësisë.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional**

33. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ndonëse nuk konsiderohet si i paaftë dhe i papërshtatshëm sipas analizës mbi vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga germa “c”, e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, çmon se problematika e konstatuar në vendimmarrjen e dhënë nga trupi gjykues në Vendimin nr. \*\*\* (pjesë e të cilit ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit), ngrenë pikëpyetje serioze për mënyrën se si subjekti ka performuar në raport me të drejtën dhe legjislacionin e zbatueshëm, e vlerësuar kjo edhe në raport me eksperiencën e gjatë në detyrë dhe aftësitë profesionale të subjektit. Trupi gjykues vlerëson se duke konsideruar edhe problematikën e konstatuar në kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk mund të jetë i aplikueshëm rekomandimi

për ndjekjen e programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, por shihet i arsyeshëm një vlerësim i kësaj rrethane në këndvështrim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga vlerësimi tërësor i çështjes, duke pasur parasysh disa aspekte si: balancën mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar, të drejtën e pretenduar dhe qëllimin që synohet të arrihet, të gërshetuara me njëra-tjetrën, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka disponuar dhe gëzuar pasuri, të cilat rezultojnë me problematika në drejtim të legjitimitetit të burimeve të tyre, por edhe duke përfituar disa prej tyre në një mënyrë të padrejtë, duke e vendosur subjektin në kushtet e pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, trupi gjykues ka vlerësuar se edhe vendimmarrja prej saj në të paktën një rast është vlerësuar si shprehje e mosbesimit ndaj mënyrës se si ka ushtruar funksionin e gjyqtarës dhe se në këtë këndvështrim Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit plotëson kushtet dhe rrethanat për zbatimin e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

Në këtë logjikë, në faktet dhe në provat e referuara në vendim, bazuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Komisionit,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohej në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 10.9.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Xhensila PINE**  
**Kryesuese**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**

**Olsi KOMICI**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Elda Faruku*

